

URDHËR
Nr. 57, datë 23.3.2023

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 28.5.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”; të pikës 2, të nenit 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, znj. Risen Xhaja, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
 2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë do të ushtrohen nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri më datë 31.12.2023.
 3. Çdo akt që bie në kundërshtim me këtë urdhër shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj